



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Gjilanit
Opština Gnjilane
Municipal Gjilan
Gilan Belediyesi

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika (d) të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 37, paragrafi 1, pika 1.3 e Statutit të Komunës së Gjilanit, (01.Nr.016-126211 të dt.06.11.2014), në zbatim të nenit 7, paragrafi 1, 2 dhe 3, nenit 10, paragrafi 1, pika 1.5 e Ligjit Nr.04/L-144 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, pas shqyrtimit të propozimit të Kryetarit të Komunës, me Rekomandim të Komitetit për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, 01.Nr.07/2016, të datës 14.01.2016 si dhe pas Rekomandimit të Komitetit për Politikë dhe Financa, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 28.01.2016, miraton këtë :

V E N D I M

Për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim për periudhë afatgjatë (99 vite), për ndërtimin dhe vendosjen e Trafostacioneve 10(20) kV.

1. Kuvendi i Komunës së Gjilanit **Aprovon Propozimin e Kryetarit të Komunës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës për periudhën afatgjatë 99 vite, pa pagesë, pjesët e ngastrave kadastrale :**

- Njësia kadastrale P-70403013-00726-0, lloji i njësisë : parcelë; lloji i pronës: pronë shoqërore; zona : urbane; sipërfaqja e parcelës : 1041 m²; vendi i quajtur: "Gumno"; lloji i shfrytëzimit të parcelës : bujqësore; shfrytëzimi aktual i parcelës: kullosë; klasa e kualitetit të parcelës : kullosë e klasit 2; Zona Kadastrale Gjilan; pronari: P.Sh. Kuvendi i Komunës Gjilan.

Sipërfaqja e nevojshme për vendosjen e trafostacionit dhe e cila ipet në shfrytëzim në këtë ngastër kadastrale është : 30m².

- Njësia kadastrale P-70403020-00250-0, lloji i njësisë : parcelë; lloji i pronës: pronë shoqërore; zona : rurale; sipërfaqja e parcelës : 3506 m²; vendi i quajtur: "Varrezat e kafshëve"; lloji i shfrytëzimit të parcelës : tokë tjetër; shfrytëzimi aktual i parcelës: i panjohur ; Zona Kadastrale Livoq i Poshtëm; pronari: P.Sh.Kuvendi Komunal Gjilan. **Sipërfaqja e nevojshme për vendosjen e trafostacionit dhe e cila ipet në shfrytëzim në këtë ngastër kadastrale është : 9 m².**
- Njësia kadastrale P-70403006-00301-0, lloji i njësisë : parcelë; lloji i pronës: pronë shoqërore; zona : rurale; sipërfaqja e parcelës :15707 m²; vendi i quajtur: "Ledina"; lloji i shfrytëzimit të parcelës: infrastrukturë; shfrytëzimi aktual i parcelës: rrugë e pakategorizuar; Zona Kadastrale Gjilan; pronari: P.Sh. Rrugët- Kuvendi Komunal Gjilan. **Sipërfaqja e nevojshme për vendosjen e trafostacionit dhe e cila ipet në shfrytëzim në këtë ngastër kadastrale është : 9 m².**

2. Pronat e përshkruara në pikën (1) të Vendimit, respektivisht sipërfaqet e nevojshme për vendosjen e trafostacioneve i ipen në shfrytëzim pa pagesë, për periudhën prej 99 viteve, **Kompanisë Kosovare për Distribuid dhe Furnizim me Energji Elektrike Sh.A. (KEDS), Divizionit të Rrjetit- Distriktit në Gjilan**, me qëllim të realizimit të investimeve në sektorin e energjisë për furnizimin e qytetarëve me energji elektrike dhe përmisimin e tensionit të rrymës elektrike sipas standardeve të parapara teknike.

3. Shfrytëzuesi, **Kompania Kosovare për Distribuid dhe Furnizim me Energji Elektrike Sh.A. (KEDS), Divizioni i Rrjetit- Distriktit në Gjilan**, obligohet që pas plotëfuqishmërisë së këtij vendimi dhe para vendosjes së trafostacioneve në parcelat e dedikuara për këtë qëllim, të pajiset me pëlqimin dhe lejen urbanistike në mënyrë që vendosja e tyre mos të bie ndesh me **Planet Urbanistike dhe Planet Zhvillimore të Komunës**.

4. Obligohet Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë që pas plotëfuqishmërisë së këtij Vendimi në bashkëpunim me Drejtorinë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, ta bënë parcelimin e sipërfaqeve të cilat ipen në shfrytëzim dhe të njejtat t'i regjistrojnë në librat kadastral si pronë e dhënë në shfrytëzim për periudhën afatgjatë për 99 vite, Kompanisë KEDS.

5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Gjilanit, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit e KK-Gjilan, ndërsa për monitorim të zbatimit kujdeset Kryesuesi i Kuvendit Komunal Gjilan.

6. Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe publikimit në gjuhët zyrtare në uebfaqen e Komunës.

01.Nr. 016-9605
Gjilan, më 28.01.2016

Kryesuesja e KK-Gjilan

/Valentina Bunjaku -Rexhepi/